



Përkushtojë së ardhmës...

UNIVERSITETI I TETOVËS

Të nderuar maturantë,

Për ju tani fillon një fazë e re jetësore - faza e përgatitjes profesionale. Tani duhet të bëni një zgjedhje të rëndësishme për të ardhmen tuaj. Duhet të përcaktoheni për drejtimin në të cilin do të studioni.

Dijet dhe përvojat që do të përfitoni gjatë studimeve universitare, do t'ju shërbejnë gjatë ushtrimit të profesionit tuaj. Duke punuar me ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore, nga puna juaj do të ketë dobi edhe shoqëria jonë. Falë dijeve e përvojave të reja, që do t'i fitoni gjatë studimeve, do të jeni të zotët që të merrni përgjegjësi shoqërore në dobi dhe në shërbim të së mirës publike dhe të komunitetit.

Për ta përmbushur misionin që ia keni vënë vetes, ju ftoj t'i ndiqni studimet në Universitetin e Tetovës, i cili ka shënuar dhe vazhdon të shënojë përparim të madh në planin e cilësisë, ka krijuar rrjet të gjerë bashkëpunimi me institucionet universitare brenda dhe jashtë vendit, është modernizuar në planin teknologjik dhe është zhvilluar në planin infrastrukturor.

Falë të arriturave të shumta, sot Universiteti i Tetovës renditet përkrah institucioneve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Universiteti ynë, me stafin e kualifikuar dhe të përkushtuar, ofron kushte optimale për studime cilësore.

Studentëve u mundëson të përfitojnë dije të thelluara nga fushat e ndryshme shkencore, të zhvillojnë aftësitë akademike, intelektuale e profesionale si dhe në të ardhmen të inkuadrohen në tregun e punës.



Fjala e Rektorit

Universiteti i Tetovës, si nxitës i reflektimit kritik për çështje të rëndësishme shoqërore, përgatit profesionistët e së nesërme, të cilët do të kontribuojnë me përgjegjësi detyre për një shoqëri më të mirë, më të fisme, më humane dhe më të zhvilluar.

Universiteti ynë, me 12 mijë studentë aktivë, që studiojnë në tri cikle studimesh: themelore, të magjistraturës dhe të doktoraturës, i ka të gjitha kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore për organizimin e studimeve cilësore. Në trembëdhjetë fakultete, me 95 programe studimore të ciklit të parë dhe 102 programe studimore të studimeve të ciklit të dytë, ofron mundësi të shumta zgjedhjeje.

Ju mund të studioni për shkencë shoqërore, të mjekësisë, shkencë natyrore, teknike, kompjuterike, inxhinierike, për shkencat e mjedisit, të edukimit, humane etj. Programet tona studimore, të strukturuar duke u bazuar në arritjet e fundit shkencore, janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, qoftë në planin vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Universiteti ynë ofron edhe trajnime e këshillime profesionale, shërbime të orientimit profesional, punë praktike dhe aktivitete kulturore e sportive.

Ne i vëmë theks të veçantë edhe zhvillimit të vazhdueshëm të infrastrukturës që ta harmonizojmë atë me nevojat dhe kërkesat e studentëve. Si një vatër e konsoliduar e arsimit sipëror, Universiteti i Tetovës, përveç të tjerave, ofron edhe kushte të përshtatshme për akomodimin e studentëve që studiojnë jashtë vendbanimit të tyre.

Universiteti i Tetovës u ka kushtuar dhe u kushton rëndësi të veçantë bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Falë bashkëpunimit me universitete, institute dhe institucione arsimore shqiptare, rajonale e ndërkombëtare, ju do të keni mundësi të përfitoni dije dhe përvoja të reja edhe në universitetet me të cilët kemi bashkëpunim të përhershëm.

Ju ftoj që të bëheni pjesë e familjes sonë universitare, që t'i shfrytëzoni të gjitha mundësitë e ofruara dhe në të ardhmen ta lartësoni edhe më shumë emrin e institucionit tonë!

Ju mirëpresim!

Rektor i Universitetit të Tetovës
Prof. dr. Jusuf Zejneli

Fakulteti Ekonomik

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Marketing dhe Menaxhment	8	240	Ekonomist i diplomuar në marketing dhe menaxhment
Ekonomi dhe Biznes	8	240	Ekonomist i diplomuar në ekonomi dhe biznes
Financa dhe Kontabilitet	8	240	Ekonomist i diplomuar në financa dhe kontabilitet
Turizëm dhe Hoteleri	8	240	Ekonomist i diplomuar në turizëm dhe hoteleri
Investigim dhe Kontroll Financiar	8	240	Ekonomist i diplomuar në investigim dhe kontroll financiar
Shpedicion dhe Sigurim	8	240	Ekonomist i diplomuar në shpedicion dhe sigurim



Cikli II

Fakulteti Ekonomik

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Marketing	2	60	Magjistër i marketingut
Menaxhment	2	60	Magjistër i menaxhmentit
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	2	60	Magjistër i menaxhimit të burimeve njerëzore
Kontabilitet dhe Auditim	2	60	Magjistër i kontabilitetit dhe auditimit
Financa, Banka dhe Sigurime	2	60	Magjistër i financave, bankave dhe sigurime
Turizëm	2	60	Magjistër i turizmit
Marketing dhe Menaxhment	4	120	Magjistër i marketingut dhe menaxhmentit
Financa dhe Kontabilitet	4	120	Magjistër i financave dhe kontabilitetit



Fakulteti Juridik

Çikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Studimet e Drejtësisë	8	240	Jurist i diplomuar
Kriminalistikë	8	240	Kriminalist i diplomuar
Studime Politike	8	240	Politikolog i diplomuar
Gazetari dhe Media	8	240	I diplomuar në gazetari dhe media



Cikli II

Fakulteti Juridik

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
E Drejta Civile	2	60	Magjistër i së drejtës civile
E Drejta Civile	4	120	Magjistër i së drejtës civile
E Drejta Penale	2	60	Magjistër i së drejtës penale
E Drejta Penale	4	120	Magjistër i së drejtës penale
E Drejta Administrative-Kushtetuese	2	60	Magjistër i së drejtës administrative-kushtetuese
E Drejta Administrative-Kushtetuese	4	120	Magjistër i së drejtës administrative-kushtetuese
E Drejta Ndërkombëtare	2	60	Magjistër i së drejtës ndërkombëtare
Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	4	120	Magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci
Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane	2	60	Magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe studimeve europiane
Kriminalistikë	2	60	Magjistër i kriminalistikës
Siguri dhe Kriminalistikë	4	120	Magjistër i sigurisë dhe kriminalistikës
Gazetari dhe Media	2	60	Magjistër i gazetarisë dhe medias
Gazetari dhe Media	4	120	Magjistër i gazetarisë dhe medias

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Informatikë	8	240	Profesor i diplomuar i informatikës
Informatikë - Shkenca Kompjuterike	8	240	Inxhinier i diplomuar i informatikës - shkencave kompjuterike
Informatikë - Informatikë Biznesi	8	240	I diplomuar në informatikë biznesi
Matematikë	8	240	Profesor i diplomuar i matematikës
Matematikë e Zbatuar	8	240	Matematikani i diplomuar
Matematikë - Matematikë Financiare	8	240	I diplomuar në matematikë financiare
Fizikë	8	240	Profesor i diplomuar i fizikës
Fizikë e Zbatuar	8	240	Inxhinier i diplomuar i fizikës
Fizikë-Kimi	8	240	Profesor i diplomuar i fizikës dhe kimisë për arsim fillor
Kimi	8	240	Profesor i diplomuar i kimisë
Kimi e Zbatuar	8	240	Inxhinier i diplomuar i kimisë
Biokimi Analitike	8	240	Inxhinier i diplomuar i biokimisë analitike
Biologji	8	240	Profesor i diplomuar i biologjisë
Biologji - Biokimi	8	240	Inxhinier i diplomuar i biokimisë
Biologji-Kimi	8	240	Profesor i diplomuar i biologjisë dhe kimisë për arsim fillor
Gjeografi	8	240	Profesor i diplomuar i gjeografisë
Ekologji	8	240	Inxhinier i diplomuar i ekologjisë

Cikli II

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Informatikë Arsimore	2	60	Magjistër i informatikës arsimore
Informatikë Arsimore	4	120	Magjistër i informatikës arsimore
Shkenca Kompjuterike	2	60	Magjistër i shkencave kompjuterike
Shkenca Kompjuterike	4	120	Magjistër i shkencave kompjuterike
Shkenca e të Dhënave	2	60	Magjistër i shkencave të të dhënave
Matematikë	2	60	Magjistër i matematikës
Matematikë Arsimore	2	60	Magjistër i matematikës arsimore
Matematikë Arsimore	4	120	Magjistër i matematikës arsimore
Fizikë Arsimore	2	60	Magjistër i fizikës arsimore
Fizikë Arsimore	4	120	Magjistër i fizikës arsimore
Fizikë Teorike	2	60	Magjistër i fizikës teorike
Fizikë e Materialeve	2	60	Magjistër i fizikës së materialeve
Fizikë Mjekësore	2	60	Magjistër i shkencave të fizikës - Fizikë mjekësore
Kimi	2	60	Magjistër i kimisë
Kimi Arsimore	2	60	Magjistër i kimisë arsimore
Kimi Arsimore	4	120	Magjistër i kimisë arsimore
Kimi e Mjedisit	2	60	Magjistër i kimisë së mjedisit
Shkenca e Materialeve	2	60	Magjistër i shkencës së materialeve
Biologji - Botanikë	2	60	Magjistër i biologjisë - botanikës
Biologji - Zoologji	2	60	Magjistër i biologjisë - zoologjisë
Biologji - Biokimi	2	60	Magjistër i biologjisë - biokimist
Gjeografi	2	60	Magjistër i gjeografisë
Ekologji	2	60	Magjistër i ekologjisë

Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Mjekësi e Përgjithshme	12	360	Doktor i mjekësisë
Mjekësi Dentare	10	300	Doktor i mjekësisë dentare
Farmacit	10	300	Magjistër i farmacisë
Mami	6	180	I diplomuar në mami
Infermieri	6	180	I diplomuar në infermieri
Fizioterapi	6	180	I diplomuar në fizioterapi
Kozmetikë me Estetikë	6	180	Kozmetist/e dhe eseist/e i/e diplomuar



Cikli II

Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Programi studimor

S ECTS Kualifikimi

**Infermier i përgjithshëm/teknik -
studime specialistike për instrumentarium**

2

60

Infermier/e i/e përgjithshëm -
Specialist i instrumentariumit

**Infermier i përgjithshëm/teknik -
studime specialistike për kujdes intensiv**

2

60

Infermier/e i/e përgjithshëm -
Specialist i kujdesit intensiv

**Infermier i përgjithshëm/teknik -
studime specialistike për kujdes familjar dhe patronazhi**

2

60

Infermier/e i/e përgjithshëm -
Specialist i kujdesit familjar dhe patronazhit

**Infermier i përgjithshëm/teknik -
studime specialistike për shëndet mental**

2

60

Infermier/e i/e përgjithshëm -
Specialist i shëndetit mental

**Teknik laborant mjekësor -
studime specialistike për laborator biokimike**

2

60

Teknik laborant mjekësor -
Specialist i laboratorisë biokimike



Fakulteti Filologjik

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	8	240	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë shqipe
Gjuhë dhe Letërsi Angleze	8	240	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë angleze
Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	8	240	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë gjermane
Gjuhë dhe Letërsi Maqedonase	8	240	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë maqedonase
Gjuhë dhe Letërsi Frënge	8	240	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë frënge



Cikli II

Fakulteti Filologjik

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Gjuhë Shqipe	2	60	Magjistër i gjuhës shqipe
Letërsi Shqipe	2	60	Magjistër i letërsisë shqipe
Metodikë e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	2	60	Magjistër i metodikës së gjuhës dhe letërsisë shqipe
Redakturë Gjuhësore	2	60	Specialist i redakturës gjuhësore
Gjuhë Angleze	2	60	Magjistër i gjuhës angleze
Gjuhë Angleze	4	120	Magjistër i gjuhës angleze
Letërsi Angleze	2	60	Magjistër i letërsisë angleze
Letërsi Angleze	4	120	Magjistër i letërsisë angleze
Metodikë e Gjuhës Angleze	2	60	Magjistër i metodikës së gjuhës angleze
Metodikë e Gjuhës Angleze	4	120	Magjistër i metodikës së gjuhës angleze
Gjuhë Gjermane	2	60	Magjistër i gjuhës gjermane
Metodikë e Gjuhës Gjermane	2	60	Magjistër i metodikës së gjuhës gjermane
Gjuhë Maqedonase	2	60	Magjistër i gjuhës maqedonase
Letërsi Maqedonase	2	60	Magjistër i letërsisë maqedonase
Gjuhë Frënge	2	60	Magjistër i gjuhës frënge



Fakulteti Filozofik

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Histori	8	240	Profesor i diplomuar i historisë
Sociologji	8	240	Profesor i diplomuar i sociologjisë
Psikologji	8	240	Psikolog i diplomuar
Filozofi	8	240	Profesor i diplomuar i filozofisë
Filologji Orientale - Gjuhë dhe Letërsi Arabe	8	240	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë arabe
Filologji Orientale - Gjuhë dhe Letërsi Turke	8	240	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë turke



Cikli II

Fakulteti Filozofik

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Histori e Mesjetës	2	60	Magjistër i historisë së mesjetës
Histori e Kohës së Re	2	60	Magjistër i historisë së kohës së re
Histori Bashkëkohore	2	60	Magjistër i historisë bashkëkohore
Sociologji	2	60	Magjistër i sociologjisë
Sociologji	4	120	Magjistër i sociologjisë
Kultura dhe Religjioni	2	60	Magjistër i kulturës dhe religjionit
Psikologji Arsimore dhe Edukative	2	60	Magjistër i psikologjisë arsimore dhe edukative
Psikologji Arsimore dhe Edukative	4	120	Magjistër i psikologjisë arsimore dhe edukative
Psikologji Klinike dhe Këshilluese	2	60	Magjistër i psikologjisë klinike dhe këshilluese
Psikologji Klinike dhe Këshilluese	4	120	Magjistër i psikologjisë klinike dhe këshilluese
Psikologji e Këshillimit me Psikoterapi	2	60	Magjistër i psikologjisë së këshillimit me psikoterapi
Psikologji e Këshillimit me Psikoterapi	4	120	Magjistër i psikologjisë së këshillimit me psikoterapi
Psikologji Organizative dhe Zhvillimi i Karrierës	2	60	Magjistër i psikologjisë organizative dhe zhvillimit të karrierës
Psikologji Organizative dhe Zhvillimi i Karrierës	4	120	Magjistër i psikologjisë organizative dhe zhvillimit të karrierës
Psikologji Sociale	2	60	Magjistër i psikologjisë sociale
Psikologji Sociale	4	120	Magjistër i psikologjisë sociale
Filozofi Bashkëkohore	2	60	Magjistër i filozofisë bashkëkohore
Filozofi Bashkëkohore	4	120	Magjistër i filozofisë bashkëkohore
Gjuhë dhe Letërsi Arabe	2	60	Magjistër i gjuhës dhe letërsi arabe
Gjuhë dhe Letërsi Turke	2	60	Magjistër i gjuhës dhe letërsi turke

Fakulteti i Arteve

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Art Figurativ - Pedagogji Figurative	8	240	Pefesor i diplomuar i artit figurativ
Art Figurativ - Pikturë	8	240	Piktor i diplomuar
Art Figurativ - Skulpturë	8	240	Skulptor i diplomuar
Art Figurativ - Grafikë	8	240	Grafist i diplomuar
Art Figurativ - Dizajn Grafik	8	240	Dizajner grafik i diplomuar
Art Muzikor - Pedagogji Muzikore	8	240	Pedagog i diplomuar i artit muzikor
Art Muzikor - Muzikologji	8	240	Muzikolog i diplomuar
Art Muzikor - Kompozim	8	240	Kompozitor i diplomuar
Art Muzikor - Solo Këndim	8	240	Solo këngëtar i diplomuar
Art Muzikor - Piano	8	240	Pianist i diplomuar
Art Muzikor - Violinë	8	240	Violinist i diplomuar
Art Muzikor - Violë	8	240	Violist i diplomuar
Art Dramatik - Aktrim	8	240	Aktor i diplomuar
Art Dramatik - Regji Filmi	8	240	Regjisor filmi i diplomuar
Art Dramatik - Montazh	8	240	Montazher filmi i diplomuar
Art Dramatik - Kinematografi	8	240	Kinematograf i diplomuar

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Pikturë	2	60	Magjistër i arteve figurative - Pikturë
Skulpturë	2	60	Magjistër i arteve figurative - Skulpturë
Grafikë	2	60	Magjistër i arteve figurative - Grafikë
Dizajn Grafik	2	60	Magjistër i dizajnit grafik



Fakulteti i Kulturës Fizike

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Kulturë Fizike dhe Shëndetësi	8	240	Profesor i diplomuar i edukimit fizik dhe shëndetësor
Trajner i Sportit - Futboll	6	180	Trajner i diplomuar në futboll
Trajner i Sportit - Basketboll	6	180	Trajner i diplomuar në basketboll
Trajner i Sportit - Vollejboll	6	180	Trajner i diplomuar në vollejboll
Trajner i Sportit - Skijim	6	180	Trajner i diplomuar në skijim
Trajner i Sportit – Sportet Mundëse	6	180	Trajner i diplomuar në sportet mundëse

Fakulteti i Kulturës Fizike

Cikli II

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Edukim Fizik	2	60	Magjistër i edukimit fizik
Edukim Fizik	4	120	Magjistër i edukimit fizik



Cikli I

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Arkitekturë	10	300	Magjistër inxhinier i arkitekturës
Ndërtimtari	8	240	Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë
Ndërtimtari - Infrastrukturë Rrugore	8	240	Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - infrastrukturë rrugore
Mekatronikë	8	240	Inxhinier i diplomuar i mekatronikës
Inxhinieria e Komunikacionit-Transportit	8	240	Inxhinier i diplomuar i komunikacionit dhe transportit
Dizajn dhe Enterier në Arkitekturë	6	180	Inxhinier i diplomuar i dizajnit dhe enterierit në arkitekturë

Cikli II

Fakulteti i Shkencave të Zbatuara

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Arkitekturë	2	60	Magjistër i shkencave në arkitekturë
Arkitekturë	4	120	Magjistër i shkencave në arkitekturë
Ndërtimtari	2	60	Magjistër i shkencave teknike në ndërtimtari
Ndërtimtari	4	120	Magjistër i shkencave teknike në ndërtimtari
Mekatronikë	2	60	Magjistër i shkencave teknike në mekatronikë
Mekatronikë	4	120	Magjistër i shkencave teknike në mekatronikë
Inxhinieria e Komunikacionit-Transportit	2	60	Magjistër i shkencave teknike në inxhinierinë e komunikacionit-transportit

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Teknologji Ushqimore	8	240	Inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore
Nutricioni	6	180	Inxhinier i nutricionit
Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore	6	180	Inxhinier i menaxhimit me cilësinë dhe sigurinë ushqimore

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit

Cikli II

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Teknologji Ushqimore	2	60	Magjistër i teknologjisë ushqimore
Teknologji Ushqimore	4	120	Magjistër i teknologjisë ushqimore
Nutricioni	4	120	Magjistër i nutricionit



Cikli I

Fakulteti i Administratës së Biznesit

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Administratë Publike	8	240	I diplomuar në administratë publike
Administrim Biznesi	8	240	Ekonomist i diplomuar në administrim biznesi
Informatikë Afariste	8	240	I diplomuar në informatikë afariste

Cikli II

Fakulteti i Administratës së Biznesit

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Administratë Publike	2	60	Magjistër i administratës publike
Administrim Biznesi	2	60	Magjistër i administrim biznesit



Fakulteti Pedagogjik
Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Edukim Parashkollor	8	240	Eduktor i diplomuar për edukim parashkollor
Mësim Klasor	8	240	Mësimdhënës i diplomuar i mësimit klasor
Pedagogji Profesionale	8	240	Pedagog i diplomuar
Edukim Special dhe Rehabilitim	8	240	Eduktor special dhe rehabilitator i diplomuar
Logopedi	8	240	Logoped i diplomuar



Cikli II **Fakulteti Pedagogjik**

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Pedagogji	2	60	Magjistër i pedagogjisë
Edukim Parashkollor	2	60	Magjistër i edukimit parashkollor
Arsimi Elementar	2	60	Magjistër i arsimit elementar
Menaxhimi në Arsim	2	60	Magjistër i menaxhimit të arsimit
Pedagogji Sociale	2	60	Magjistër i pedagogjisë sociale
Pedagogji Sociale	4	120	Magjistër i pedagogjisë sociale
Arsim Inkluziv	2	60	Magjistër i arsimit inkluziv
Autizmi dhe Aftësia e Kufizuar Intelektuale	2	60	Magjistër i autizmit dhe aftësisë së kufizuar intelektuale
Logopedi dhe Dëmtime në Dëgjim	2	60	Magjistër i logopedisë dhe dëmtime në dëgjim
Logopedi dhe Dëmtime në Dëgjim	4	120	Magjistër i logopedisë dhe dëmtime në dëgjim



Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë

Cikli I

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Prodhimtari Bimore	8	240	Inxhinier i diplomuar i bujqësisë - Prodhimtari bimore
Agrobiznes	8	240	Inxhinier i diplomuar i bujqësisë - Agroekonomist
Mjekësi Veterinare	10	300	Doktor i mjekësisë veterinare







Erasmus + është program për edukim, trajnim, rini dhe sport, i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Komisionit Evropian.

Universiteti i Tetovës ka fituar Kartën

(licencën) për Erasmus + në mars të vitit 2013 dhe deri më tani ka nënshkruar marrëveshje për mobilitet të studentëve dhe të stafit akademik dhe administrativ, me 78 universitete nga 13 vende të ndryshme evropiane.

Përfitimet nga programi Erasmus +:

- Përvojë unike e studimit apo mësimdhënies në Evropë.
- Njohje e afërt me Evropën dhe arsimin e lartë evropian.
- Përmirësim i aftësive gjuhësore.
- Këmbim i njohurive, ideve dhe kontakteve.

Kriteret për mobilitet të studentëve:

- Të jetë student i vitit të dytë ose më lart.
- Të njoh gjuhën angleze ose gjuhën e universitetit pritës.
- Të dorëzojë aplikimin për mobilitet dhe dokumentacionin, brenda afatit të specifikuar kohor.

Kohëzgjatja e mobilitetit të studentëve:

- Për studime: 3-12 muaj (1 ose 2 semestra).
- Për punë praktike: 2-12 muaj.

Kriteret për mobilitet të stafit akademik dhe administrativ:

- Të njoh gjuhën angleze ose gjuhën e universitetit pritës.
- Të dorëzojë aplikimin për mobilitet dhe dokumentacionin, brenda afatit të specifikuar kohor.

Kohëzgjatja e mobilitetit të stafit akademik dhe administrativ:

- Për mësimdhënie: 2-5 ditë (8 orë mësimi).
- Për trajnim: 2-5 ditë.



"Nëse në të ardhmen do të kishit dashur që të kujtoni gjëra të bukura gjatë të qenit student, eksperiencën më të bukur që mund t'i dhuronit vetes është pjesëmarrja në Erasmus + për një program studimor".



"Studimi dhe jetesa jashtë vendit është një hap i madh. Dalja nga zona e rehatisë nuk është gjithmonë e lehtë, por sigurisht që do të rritë aftësitë tuaja personale dhe profesionale. Pjesa më e vështirë është vendimi për të dalë, por ne mund të garantojmë që ju nuk do të zhgenjeheni!".

"Do t'u kisha thënë të gjithë studentëve të mos e humbin këtë mundësi, sepse është një eksperiencë që ta ndryshon jetën".

"Sinqerisht, mendoj se është një eksperiencë e mrekullueshme e cila duhet të provohet, sepse fjalët nuk do të ishin të mjaftueshme për ta përshkruar!



Personalisht ndihem shumë e privilegjuar dhe me fat për vendimin që kam marrë edhe pse ka qenë diçka që nuk e kam planifikuar paraprakisht, por që nga dita e parë doli që ishte vendimi më i mirë që kam marrë, inkuadrimi në familjen e Erasmusit".



APLIKIMI



UT MOBILE APP




UnitEd - University of
Tetova
UNIKAN

18 MB 1923 D 100+ Downloads

Instal



UnitEd - University of Tetova
University of Tetova




UDHËZUES PËR APLIKIM DHE REGJISTRIM**SI BËHET APLIKIMI?**

- Fillimisht realizo pagesën për aplikim në bankë, postë ose online në: <https://epay.unite.edu.mk>
- Fotografo (skeno) fletëpagesën dhe dokumentet për aplikim:
 - ▶ *Certifikatën e shtetësisë;*
 - ▶ *Certifikatën e lindjes;*
 - ▶ *Dëftesat për kryerjen e shkollimit të mesëm;*
 - ▶ *Diplomën për kryerjen e shkollimit të mesëm;*
 - ▶ *Vërtetim që dëshmon se kandidati është i punësuar (për atë që dëshiron të studiojë me korrespondencë);*
 - ▶ *Për informacione plotësuese lexoni udhëzimet në: www.unite.edu.mk/apply*
- Plotëso formularin për aplikim online në: apply.unite.edu.mk.



apply.unite.edu.mk



UDHËZUES PËR APLIKIM DHE REGJISTRIM

- ▶ Shkruaj saktë emailin dhe të dhënat tua;
 - ▶ Bashkëngjit (attach) dokumentet e fotografuara (skenuara) në rubrikat përkatëse;
 - ▶ Shëno brenda rubrikave notat e shkollimit të mesëm siç janë në deftesë;
 - ▶ Pas plotësimit të të gjitha të dhënave dërgo formularin.
-
- Pas dërgimit të formularit me emailin që keni aplikuar do të pranoni konfirmim të aplikimit tuaj dhe fjalëkalimin (password) e profilit të aplikimit prej ku do të mund ta bëni edhe regjistrimin pas pranimit.
 - **Dorëzo dokumentet në fakultetin ku ke aplikuar online, brenda datave për aplikim;**
 - Përgjegjësinë për aplikimin online e bart vetë kandidati dhe është parakusht për dorëzimin e dokumenteve në administratë.
 - Në profilin tuaj të aplikimit e mbikëqyrni fazën për dorëzimin e dokumenteve në administratë, shqyrtimin e dokumentacionit nga komisioni, rangimin, rezultatet preliminare dhe rezultatet përfundimtare.

Rezultatet e pranimit do të shpallen në profilin tuaj dhe ueb faqen e Universitetit të Tetovës: **www.unite.edu.mk**.

Për detajet tjera rreth aplikimit mund ta vizitoni ueb faqen: <https://unite.edu.mk/apply/> në rubrikën PYETJE MË TË SHPESHTA.

UDHËZUES PËR APLIKIM DHE REGJISTRIM

SI REALIZOHET REGJISTRIMI?

Kandidati i pranuar në rezultatet përfundimtare, fillimisht i realizon pagesat për semestrin dhe detyrimet tjera, pastaj e regjistron semestrin nga profili i aplikantit përmes emailit me të cilin ka aplikuar dhe fjalëkalimin (password) e pranuar në email.

Te shërbimi studentor i fakultetit dorëzon:

- Fletëparaqitje për regjistrim;
- Tri fotografi;
- Pagesën e semestrit të parë në shumën që është paraparë për kuotën e pranuar;
- Pagesat tjera për: (Shumat që duhet t'i paguani i lexoni në Konkurs);
- Index;
- Veprimtaritë informative, kulturore të studentëve të Universitetit;
- Regjistrimi përfundon vetëm nëse dokumentacioni i mësipërm dorëzohet te shërbimi studentor.

KUJDES! Çfarë ndodh nëse je pranuar, por nuk ke bërë regjistrim në afatin e caktuar?

- Konsiderohet se ke hequr dorë nga studimet edhe pse je pranuar;
- Në konkursin e ardhshëm për praninë të studentëve vendi i juaj shpallet i lirë;
- Ke të drejtë të aplikosh përsëri sipas procedurave të njëjta;
- Aplikon vetëm në ato programe studimore ku kanë mbetur vende të lira;
- Nuk ruhet statusi i kuotës që ke pasur në afatin paraprak.

UDHËZUES PËR APLIKIM DHE REGJISTRIM

SI REALIZOHET RANGIMI I KANDIDATIT ?

- Radhitja e kandidatit në listë bëhet në bazë të pikëve të fituara;
- Kandidati që ka aplikuar për status të rregullt të studimeve dhe ka pikë më të larta, hyn në kuotën shtetërore për aq vende të lira sa janë paraparë në Konkurs;
- Kandidatët tjerë hyjnë me vetëfinancim aq sa ka vende të lira me konkurs për këtë kuotë;
- Pasi të plotësohen të gjitha vendet e lira, kandidatët tjerë mbeten të papranuar;
- Kandidatët që aplikojnë me korrespondencë nuk konkurrojnë në këto dy kuota, por ata konkurrojnë me kandidatët që aplikojnë me status të studimeve me korrespondencë. Për këtë kategori të kandidatëve vlejnë rregullat që u theksuan më lart;
- Pasi të plotësohet numri i kandidatëve me korrespondencë, të tjerët mbeten të papranuar, pavarësisht se mund të ketë vende të lira në kuotë shtetërore apo kofinancim.

KANDIDATËT QË NUK JANË SHTETAS TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT?

- Shtetasit e huaj, gjatë rangimit nuk konkurrojnë me shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Numri i vendeve për këta kandidatë është i kufizuar në 20% në nivel të fakultetit;
- Pasi të plotësohet ky numër në nivel të fakultetit, kandidatët tjerë nuk pranohen;
- Pas pranimit këta kandidatë duhet të rregullojnë nostrifikimin dhe lejeqëndrimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

KUR PARASHTROHET ANKESË?

- Në afat prej 8 orësh pas shpalljes së rezultateve preliminare (online ose me shkrim);
- Nëse emri nuk është i shpallur në listë (emri patjetër duhet të jetë i publikuar pavarësisht rezultatit të arritur);
- Nëse pikët e suksesit janë llogaritur gabimisht;
- Nëse Komisioni gabimisht të ka ranguar në ndonjë program tjetër studimor;
- Nëse nuk e ke të qartë arsyen e mospranimit etj.